



Republika e Kosovës
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Ri plehërimi i grurit me materie azotike – Masë e rëndësishme agroteknike



Të nderuar fermerë,

Ri plehërimi i grurit me materie azotike është një masë e rëndësishme agroteknike, e cila ka një ndikim të madh në zhvillimin e kulturave bujqësore.

Përse është e rëndësishme ri plehërimi i grurit?

Materiet azotike, siç janë plehrat organike dhe kimike që përmbajnë azot, janë thelbësore për rritjen e shëndetshme të grurit. Azoti është një nga elementët kryesorë që kontribuon në formimin e klorofilit, duke ndihmuar kështu në procesin e fotosintezës dhe në rritjen e bimëve.

Përfitimet e ri plehërimit me Azot:

- Ri plehërimi i duhur me azot ndihmon në rritjen e masës bimore, duke kontribuar kështu në një prodhim më të lartë të grurit.
- Azoti ndihmon në formimin e proteinave, çka është esenciale për cilësinë e drithërave dhe përfitimet ekonomike që lidhen me to.
- Bimët që janë të mirë plehëruara janë më të qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe kushteve të këqija të motit.



Ri plehërimi mund të bëhet në disa faza, duke pasur parasysh fazat e rritjes së grurit. Një aplikim në fillim të zhvillimit dhe një tjetër gjatë periudhës së rritjes intensive mund të japin rezultate optimale:

Ri plehërimi i parë i grurit duhet të bëhet në fillim të vegjetacionit pranveror, kur temperaturat ditore stabilizohen në 10-15°C. Avantazhe kanë formulimet me azot në formë të nitrates dhe amoniaku NAG, sepse format nitrates të azotit përvetësohen më shpejt, edhe në temperatura më të ulëta.

Ri plehërimi i dytë i grurit, përdorim NAG-un (27% N), në sasi rreth 150 kg/ha, varësisht nga gjendja momentale e zhvillimit të bimëve të grurit. Me ri plehërimin e dytë hedhim sasinë e mbetur të materieve azotike për nevojat e bimëve të grurit, pra rreth 30% të plehut azotik për ushqim plotësues të bimës së grurit. Ri plehërimi i dytë bëhet një muaj pas ri plehërimit të parë dhe fillon nga 01-15 prill, duke pasur efekt korrektues.

Ri plehërimi i tretë i grurit në praktikën tonë nuk është shumë i pranuar, edhe pse e njëjta sasi e azotit e shpërndarë në tri këste jep rezultate më të mira sesa në dy këste, sepse humbjet e azotit janë më të vogla. Në disa vite, kur pas ri plehërimit të dytë bien shumë reshje, ri plehërimi i tretë është teknologjikisht dhe ekonomikisht i justifikuar, edhe pse në përgjithësi mund të themi se ri plehërimi i tretë zakonisht rrit cilësinë, ndërsa prodhimin shumë rrallë.

Para se të filloni plehërimin, është e rekomandueshme të bëni një analizë të tokës për të përcaktuar sasinë e azotit dhe elementeve të tjerë që mungojnë. Sasia e materieve azotike duhet të përcaktohet në bazë të nevojave specifike të kulturës suaj dhe të rekomandimeve të specialistëve, si:

- Në ri plehërimin e parë të përdoren: 100-120 kg/ha NAG (27% N)
- Në ri plehërimin e dytë të përdoren: 180-220 kg/ha NAG (27% N)
- Në ri plehërimin e tretë të përdoren: 100 kg/ha ose 50 kg Ure (46% N)

Nëse shpërndarja e plehut nuk bëhet në tri faza, atëherë sasia e ri plehërimit të tretë duhet të shpërndahet gjatë ri plehërimit të parë dhe të dytë.

Masat e përkujdesjes:

Sasitë e mëdha të azotit ndikojnë në rrëzimin e bimëve për tokë, duke zvogëluar rendimentin dhe cilësinë. Mungesa e azotit ndikon në rritjen dhe zhvillimin e dobët të pjesës vegetative të bimës së grurit. Sasia e materies aktive gjatë ri plehërimit duhet të sillet nga 80-150 kg/ha.



Nëse keni ndonjë pyetje ose nevojë për këshilla të mëtejshme, ju inkurajojmë të kontaktoni Këshilltarët bujqësorë në Qendrën Informative Këshilluese Komunale tuaj ose mund të drejtoheni te:

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish-Ramiz Sadikut, Nr. 120, Kati III, Prishtinë – Kosovë

Tel. 383- (0)3820038426